



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Tabela paraprake e vlerësimit të fakteve/vlerësimit nga monitorimi		Datë: 13/0/2019	Numri i seancës për këtë çështje:
<i>Ky monitorim u realizua në kuadër të projektit nr.2 "Për të rritur transparencën, gjithëpërfshirjen dhe përgjegjshmërinë në procesin e Vettingut" – projekt i mbështetur financiarisht nga Fondacioni për Shoqërinë e Hapur Shqipëri (OSFA) dhe zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH).</i>			
A. Informacioni bazë			
Institucioni dhe tema:	<i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit</i>		
Emri i subjektit të rivlerësimit	<i>Hysni Demiraj</i>		
Pozicioni i punës/ qyteti nëse nuk është Tirana	<i>Kryetar i Gjykatës së Apelit të Tiranës</i>		
A u shty seanca dhe a ishte e arsyeshme kjo shtyrje?	<i>Pas shqyrtimit të çështjes dhe paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare nga subjekti, I cili kërkoi konfirmimin në detyrë, trupi gjykues vendosi shtyrje të seancës, për datën 15 shkurt.</i>		
A u shpall vendimi apo jo (Ju lutem paraqisni arsyet në mënyrë të përmbledhur)	<i>Vendimi nuk u shpall në përfundim të seancës, pasi trupi gjykues caktoi datën 15 shkurt.</i>		
B. Aktorët që marrin pjesë në proces/seanca			
Trupa gjykuese (emrat)	<i>Roland Ilia(Kryetar) ; Etleda Çiftja (anëtare); Pamela Qirko(relatore)</i>		
Monitoruesit ndërkombëtarë (emrat)	<i>Theo Jacobs</i>		
Mbrojtje me avokat apo mbrojtje personalisht (specifikoni)	<i>U krye personalisht nga subjekti.</i>		
Monitoruesi/ja i/e KSHH:	<i>Dafina Zeneli</i>		
Anëtarë të tjerë të publikut të pranishëm?	<i>Pjesëmarrës ishin rreth 20 persona. Ndodhej Avokatja e Popullit, si edhe disa qytetare, mes te cilëve edhe individë që kishin pasur procese gjyqësore, te gjykuara nga subjekti dhe e akuzonin për vendim të padrejte.</i>		
Media e pranishme:	<i>Per seancën u shfaq shume interes nga mediat. Ishin te pranishëm gazetarë dhe operatorë te disa televizioneve dhe portaleve.</i>		
C. A vendosi institucioni i vettingut ta bëjë vettingun për të tre kriteret apo bazuar vetëm në një apo dy prej tyre?	<i>Po</i> <i>Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, vendosi të kryeje vlerësimin për të treja kriteret: pasuror, moral dhe profesional.</i>	<i>Nëse po, si u justifikua ai?</i>	<i>Nëse po, si ka reaguar subjekti ndaj kësaj ?</i>

D. Përmbajtja e çështjes (Vlerësimi i kritereve)	Argumenti	kush e ka dhënë argumentin	A u diskutua? Prova? A u kalua barra e provës ?
D1. Pasuria	Të ardhurat familjare për periudhën e deklaruar 2003-2017 janë 18.9 milionë lekë. 87% të të ardhurave familjare nga paga si gjyqtar; 12 %, paga e bashkëshortes; 1%, mësimdhënie, të tjera	Raportet e ILDKPI	Subjekti paraqiti pretendimet e tij për gjetjet e KPK-së. Në lidhje me apartamentin theksoi se është blerë me çmimin e tregut në atë kohë dhe se ka depozituar kontrata të disa objekteve të tjera, të blera në atë zonë. Subjekti kundërshtoi që të jetë trajtuar me çmim preferencial garazhi, për të cilin tha se nuk i plotëson kushtet për garazh dhe e quajti një post parkimi të pambuluar. Trupi gjyqës deklaroi se shpjegimet dhe provat do të trajtohen në mënyrë objektive.
	PASURIA familjare 11.2 milionë lekë, në vitin 2017 -Pasuri të paluajtshme me vlerë 9.6 milionë lekë; -Likuiditete bankare 1.1 milionë lekë; -Kursime në cash 500 mijë lekë PASURI të paluajtshme -Apartament banimi me sipërfaqe 141.4 m2 në Tiranë, porositur në vitin 2007, me vlerë 65,751 euro. Blerë me të ardhurat nga paga dhe huaja prej 30 mijë euro e vëllait; - Garazh me sipërfaqe 29.2 m2, me vlerë 8.000 euro Subjekti i rivlerësimi ka kryer deklaram të saktë të pasurisë, burimet dhe origjina të identifikueshme dhe të ligjshme. Subjekti është shprehur i gatshëm, për të bashkëpunuar me organet e vlerësimi.	ILDKPI	
	Nga hetimi i thelluar i kryer nga KPK, ku u përshinë, dokumentet dhe raportet e ILDKPI-së, provat e paraqitura nga subjekti edhe me kërkesë të komisionit, si edhe dokumente të tjera, rezultojnë se ka disa pasaktësi. Sipas relatores, nga provat e mbledhura, rezultojnë se subjekti është trajtuar me çmim preferencial për blerjen e apartamentit 141.4 m2. Komisioni konstatoi se çmimi i apartamentit ishte 412 euro/m2, ndërkohë që e njëjta kompani aplikonte çmime deri në 800 euro/m2, në të njëjtën zonë. Konstatohet deklaram i pasaktë në lidhje me sipërfaqen e një garazhi; konkretisht 15 m2 pranë ILDKPI dhe 29.2 m2 në provat e paraqitura për procesin e Vetingut. Po ashtu ka edhe ndryshim të kontratës mbi vlerën e pronës, nga 12.500 euro e deklaruar në fillim, në 8,000 euro. KPK konstatoi se nuk ishte provuar nga subjekti, që huadhënësi (një biznesmen) i 5 milion lekëve të kishte pasur likuiditete të mjaftueshme. Edhe vëllai i subjektit, nga analiza e KPK-së, rezultoi se nuk kishte burime të mjaftueshme për dhënien e borxhit prej 30 mijë euro. Relatorja u shpreh se është konstatuar gjithashtu se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për shlyerjen me këste të huasë, prej 5 milion lekësh nga i njohuri i familjes (biznesmen), si edhe 2 mijë euro vëllait të tij.	KPK	
D2. Figura /Kontaktet me krimin e organizuar	Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, në lidhje me pastërtinë e figurës, e ka gjetur Kryetarin e Gjykatës së Apelit të Tiranës, Hysni Demiraj, të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.	DSIK	Subjekti u ndal tek kualifikimet profesionale, duke sjellë në vëmendje, ndër të tjera zgjedhjen e tij si anëtar i KLD-së si edhe faktin se është pjesë e regjistrimit të ekselencës, për studimet master në të drejtë penale.
	KPK, nuk gjeti asnjë element, që të tregojë se subjekti i rivlerësimi ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.	KPK	

<p>D3. Vlerësimi i aftësive profesionale dhe etikës</p>	<p>Inspektoriati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ka kryer analizën për aspektin profesional të gjyqtarit, pasi rishikoi 3 dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe 5 dokumente ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, KLD konkludoi se vendimet e dhëna nga subjekti janë të thjeshta dhe të arsyeshme. Edhe pse ka konstatuar disa mangësi në dosje, KLD shprehet se ofron garanci profesionale.</p>	<p>KLD</p>	<p>Subjekti i rivlerësimit, theksoi se ka punuar më ndershëmëri, nuk ka kryer asnjë shkelje, madje u vetëvlerësua ndër 20-30 gjyqtarët më të mirë të vendit. Lidhur me denoncimet e përmendura nga relatorja, gjyqtari dha shpjegimet, duke u ndaluar kryesisht tek ngjarja e vitit 1997, ku mbeti i plagosur dhe një gjyqtar. Subjekti tha se qëllimi i tij ishte të lajmëronte forca shtesë të policisë pas një sulmi mbi gjykatën, ku ai ishte goditur me levë ndërsa një punonjës policie ishte plagosur.</p>
<p>E. Konkluzione dhe komente të monitoruesit të KSHH (Vlerësimi paraprak i monitoruesit të KSHH për aspektet e procesit të drejtë ligjor (publiciteti, etika e organeve të vettingut dhe përfaqësuesit të OMN , si e vlerësoni hetimin administrativ, të drejtat e mbrojtjes së subjektit, barazia e mjeteve ligjore, parimi i kontradiktoritetit, koha e arsyeshme, e drejta për të paraqitur prova dhe e drejta për tu dëgjuar, etj.)</p>	<p>Seanca e rivlerësimit për subjektin Hysni Demiraj, zgjati për dy orë, ku nuk munguan tonet e larta mes tij dhe monitoruesit ndërkombëtar si dhe akuzat e disa qytetarëve. Pas relacionit të trupit gjykues, subjekti paraqiti shpjegimet e tij. Mes subjektit dhe përfaqësuesit të ONM-së, Theo Jacobs, pati replika në lidhje me huanë prej 5 milionë lekësh, marrë një të njohuri të familjes si edhe për ngjarjen e vitit 1997, në gjykatën e Gjirokastrës. Vëzhguesi i ONM-së ngriti pikëpyetje mbi këtë ngjarje, duke i kujtuar se nuk është detyra e gjyqtarit të bëjë “kaubojsin”.</p> <p>“Ngjarja nuk ka qenë për t’u sjellë si kaubojs, por për të mbrojtur jetën time në radhë të parë, sepse isha goditur me levë hekuri. Pastaj u ndikova dhe emocionalisht, pasi pashë policin me kokë të çarë. Në Gjirokastër kemi punuar në një situatë të jashtëzakonshme në ‘97, policia nuk kishte asnjë pushtet mbi Lazaratin”, u shpreh gjyqtari, që kërkoi ndjesë edhe për tonet e larta ndaj monitoruesit ndërkombëtar.</p> <p>Monitoruesi ndërkombëtar u ndal gjatë në çështjen e huasë, duke i kërkuar shpjegime, madje duke e konsideruar si shkelje etike për gjyqtarin marrjen e huasë nga persona privatë, me një kontratë të nënshkruar 3 muaj më vonë dhe pa interesa, teksa në bankë asokohe interesat ishin mjaft të larta. Subjekti u shpjegua për këtë marrëdhënie me mikun e familjes së bashkëshortes, duke përdorur të drejtën zakonore shqiptare. Ai u shpreh se biznesmeni, i ishte vetëofruar për ta ndihmuar, kur e pa të shqetësuar se nuk kishte ku të jetonte, pas zgjedhjes si anëtar i KLD-së. Për më tepër, tha se nuk kishte dhënë asnjë interes për huanë edhe pse në kontratë ishte shënuar 2.5%.</p> <p>Në fund gjyqtari kërkoi konfirmimin në detyrë. Fjala e subjektit u shoqërua me reagime nga disa qytetarë të pranishëm, të cilët në fund të seancës me tone të larta e akuzuan për një vendim të padrejtë për çështje pronash.</p> <p>Në lidhje me parimin e publicitetit të gjyqimit, rezultoi se është respektuar. Data, vendi, dhe ora e zhvillimit të seancës dëgjimore u njoftuan paraprakisht, në faqen zyrtare të KPK-së. Seanca ishte e hapur për të interesuarit, që mund ta ndiqnin atë, pas shënimit të gjeneraliteteve në hyrje të sallës. Mediave po ashtu, u ishte krijuar hapësira e nevojshme, për ndjekjen e seancës. Kamerat u lejuan të xhironin vetëm gjatë hapjes së seancës.</p>	<p>Relatorja</p>	